

## STATUT

### I

## SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "AMEL ENERGY" SHPK

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar, themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Amel Energy" SHPK, veprimtaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

### Neni 1

#### Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

### Neni 2

#### Ortakët e shoqërisë

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themelohet nga ortaku i Vetëm i saj, Zj. Entela Sako, e bija e Petrit, e lindur në Elbasan më 25.08.1977, e identifikuar me anë të Letërnjoftimit Elektronik me Nr. Personal H75825068D, (këtu e më poshtë referuar edhe si 'Ortak i vetëm').

### Neni 3

#### Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" me ortak të vetëm ose "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).



## Neni 5

### Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga "Malokët", Bërksullë, Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në cilësinë e ortakut ose aksionerit në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

## Neni 6

### Dokumentet e shoqërisë

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
- numrin unik të identifikimit;*
  - formën ligjore të shoqërisë;*
  - vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
  - të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
  - vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

## Neni 7

### Objekti i veprimtarisë

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:
- Prodhim dhe shitje energjie nga burime të tjera alternative, burime të rinovueshme, ndërtim centralesh fotovoltaike, energji solare, etj, në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.”.
  - *Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.*
- 7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve/Ortakut të vetëm.



## **Neni 8**

### **Kapitali themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **10.000 (dhjetëmijë) Lekë**.
- 8.2 Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale **10.000 (dhjetëmijë) Lekë** dhe zotërohet nga Ortaku i vetëm i shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Transferimi i pjesëve të kapitalit**

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve nëse Asambleja e Ortakëve/ Ortaku i vetëm do të marrë vendim për shndërrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me dy ose disa ortakë. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

## **Neni 10**

### **Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve/ Ortakut të vetëm si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2 Ortakët/ Ortaku i vetëm, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.



## Neni 11

### Asambleja e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga Ortakët e shoqërisë/ Ortaku vetëm i shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga Ortakët/ Ortaku i vetëm.
- 11.2 Asambleja e ortakëve/ Ortaku i vetëm ka këto kompetenca kryesore dhe miraton sa më poshtë vijon:
- *ndryshimi i dispozitave të statutit,*
  - *zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,*
  - *emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
  - *miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
  - *miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*
  - *ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë apo riorganizimin e saj*
  - *miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë,*
  - *mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme e shoqërisë*
  - *çështje të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi si dhe nga dispozitat e këtij Statuti në mënyrë të shprehur.*
- 11.3 Asambleja e ortakëve/ Ortaku i vetëm mblidhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe në distancë nëpërmjet video konferencës si dhe në një vend apo shtet tjetër të ndryshëm nga vendndodhja e selisë së shoqërisë.
- 11.4 Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;



ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

- 11.5 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund t'i dërgohet Ortakut të vetëm edhe nëpërmjet postës elektronike, por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.
- 11.6 Ortakët/Ortaku i vetëm mund të përfaqësohen/t në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të përgjithshme apo të posaçme të lëshuar paraprakisht, prej tyre/tij.

## Neni 12

### Vendimmarrja

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, Asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

### Neni 13

#### Administratori

- 13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve /Ortakut të vetëm. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Administratori i parë i shoqërisë është: Z. Elian Shena, i biri i Syrja, i lindur në Progonat më 28.04.1991 dhe banues në Tiranë, i identifikuar me anë të Letërnjoftimit Elektronik me Nr. Personal J10428140M. Administratori i parë është i autorizuar për kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të nevojshme me qëllim regjistrimin e shoqërisë **"Amel Energy" SHPK** të themeluar nga unë në cilësinë e Ortakut të Vetëm dhe fillimin e veprimtarisë sipas objektit të përcaktuar në këtë Statut të nënshkruar prej meje.
- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve/Ortakut të vetëm propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve/ Ortakut të vetëm.
- 13.4 Administratori mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij për realizimin e veprimeve të caktuara ose kategori veprimesh tek persona të tretë të punësuar ose jo në shoqërinë tregtare.
- 13.5 Administratori ka të drejtë të kryejë çdo veprim brenda kompetencave të tij ose të dhëna me Vendim të Asamblesë së Ortakëve/ Ortakut të vetëm si dhe të krijojë, të ndryshojë apo të dalë nga marrëdhënie juridike me palë të treta.

### Neni 14

#### Kontrolli financiar

Asambleja e Ortakëve/Ortaku i vetëm mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.



## **Neni 15**

### **Viti financiar**

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë përpunet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

## **Neni 16**

### **Bilanci dhe Dividendët**

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve/ Ortakut të vetëm për miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e ortakëve/ Ortaku i Vetëm që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

## **Neni 17**

### **Likuidimi dhe prishja**

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përpunje me kërkesat ligjore.

## **Neni 18**

### **Dispozita mbyllëse**

Ky Statut hartohet në 2 (dy) ekzemplarë në gjuhën shqipe.

**ORTAKU I VETËM THEMELUES**

**Zj. ENTELA SAKO**

Entela Sako 